

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Gender Budget Watchdog Network
for a gender equal region

 Sweden
Sverige

KOMENTET MBI BUXHETIN

Rrjeti i Grave të Kosovës



2025

Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Nga ndarjet vjetore të buxhetit në zotimet afatmesme: Rishikim gjinor me vizion afatgjatë i buxhetit të Kosovës dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve

Përgatitur nga Elirjeta Beka dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grave të Kosovës,
si pjesë e Rrjetit Mbikëqyrës së Buxhetit Gjinor¹

Hyrje

Me buxhetim të përgjegjshëm gjinor (BPGj) synohet të sigurohet që fondet po alokohen dhe shpenzohen për të adresuar nevojat e ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave, të cilat nevoja janë identifikuar përmes analizës gjinore. BPGj përfshin integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e procesit buxhetor, duke përfshirë ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë mes grave dhe burrave. Sipas [Ligjit të Kosovës nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore \(LBGj\)](#), BPGj përfshin integrimin gjinor në procesin buxhetor dhe 'ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve' për të promovuar barazinë mes grave dhe burrave.² Integrimi gjinor përkufizohet si përfshirja e perspektivës gjinore në :planifikimin, miratimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit, politikave, programeve dhe buxheteve në të gjitha fushat politike, ekonomike dhe sociale”, me qëllim avancimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë.³ Moszbatimi i BPGj-së, siç parashihet nga ky ligj, përbën shkelje ligjore dhe i nënshtrohet sanksioneve. Më tej, në qarkoret buxhetore,⁴ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka kërkuar rregullisht përfshirjen e BPGJ-së si aneks në kërkesat për ndarje buxhetore.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) është dokumenti kryesor për planifikimin afatmesëm të buxhetit dhe për udhëzimin e hartimit të Buxhetit Vjetor të Kosovës për vitin 2026. Kjo kornizë synon të analizojë në mënyrë të plotë mjedisin makroekonomik të vendit. KASH krijon themelin për vendimet buxhetore duke ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të sistemit ekonomik dhe duke përafruar ndarjet buxhetore me objektivat e qeverisë.⁵ Prioritetet afatmesme për reformat ekonomike rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2023-2025, të cilat janë rezultat i dialogut të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) për qeverisjen ekonomike. Për vitet 2025-2027, Qeveria e Kosovës ka prioritetizuar agjendat horizontale të nxjerra nga dokumentet strategjike si Programi i Qeverisë 2021-2025⁶ dhe Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2030.⁷

Proceset transparente të buxhetit janë thelbësore për të siguruar llogaridhënien e qeverisë dhe për të rritur besimin e publikut. Buxhetimi i bazuar në programe mund të përmirësojë transparencën duke mundësuar një kuptim më të saktë të burimeve të alokuara për avancimin e barazisë gjinore. Megjithatë, Kosova përdor buxhetimin e ndarë sipas zërave dhe jo buxhetimin e bazuar në programe, çka paraqet vështirësi në përcaktimin e shumës së buxhetit të ndarë për barazi gjinore dhe në vlerësimin e kontributeve që shpenzimet kanë bërë për arritjen e barazisë gjinore. Prandaj, në Kosovë, KASH dhe Aneksi i BPGj-së i kërkuar nga MFPT janë veçanërisht të rëndësishëm për komunikimin me qytetarët,

¹ Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjinor (RrMBGj) është rrjet i përbërë nga 100 organizata të shoqërisë civile, i themeluar në vitin 2019, me misionin për të avancuar BPGj-në në Ballkanin Perëndimor, Republikën e Moldavisë dhe më gjerë, me qëllim të përdorimit më efikas, efektiv, transparent dhe të drejtë të burimeve nga të cilat përfitojnë gratë dhe burrat e profileve/grupeve të ndryshme. Ky koment është përgatitur me mbështetje financiare nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADA) dhe Suedia si pjesë e Iniciativës II të Rrjetit Mbikëqyrës së Buxhetit Gjinor. Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësi operative e ADA-së, është partneri kontraktual që mbështet këtë projekt. Përbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e Qendrës për Hulumtim dhe Politikëbërje, ADA-së, apo Suedisë.

² Neni 3, paragrafi 1.17.


³ Neni 3, paragrafi 1.16.

⁴ Për shembull, shih Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Qarkorja Buxhetore 2025/01, maj 2024.

⁵ Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve \(KASH\) 2025-2027](#).

⁶ Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025](#), qasur më 23 gusht 2024.

⁷ Republika e Kosovës, [Strategjia dhe plani kombëtar për zhvillim 2030](#).




si tatimpagues, lidhur me cilat linja buxhetore do të kontribuojnë në objektivat e Qeverisë për barazinë gjinore.

Ky Koment analizon Ligjin Vjetor të Buxhetit 2025 në kontekstin e KASH-it të ardhshëm, duke vlerësuar deri në çfarë mase këto dokumente pasqyrojnë zotimet e Qeverisë për BPGj-në. Së pari, shqyrton shkurtimisht transparencën e procesit buxhetor. Së dyti, ofron një pasqyrë të trendeve dhe alokimeve buxhetore, duke analizuar se sa mirë janë të integruara objektivat, treguesit dhe alokimet për barazinë gjinore në sektorë të ndryshëm. Së treti, vlerëson nëse Buxheti 2025 do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore, duke përfshirë shqyrtimin nëse ai i është përgjigjur rekomandimeve të mëparshme të RrGK-së për adresimin e çështjeve kyçe drejt arritjes së barazisë gjinore. Së katërti, analizon përfshirjen e aspektit gjinor në KASH 2025-2027. Së fundmi, Komenti ofron rekomandime për përmirësimin e përfshirjes së aspektit gjinor në KASH-et e ardhshme dhe në Buxhet Vjetor 2026, me synimin për të avancuar barazinë gjinore. Kjo analizë është përgatitur nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), si pjesë e Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor (RrMBGj).

Transparenca dhe llogaridhënia


Projektligji për buxhetin e vitit 2025 nuk është vënë asnjëherë në dispozicion për konsultim publik, përkundër kërkesave të përcaktuara në [Rregulloren \(GRK\) - Nr.17/2024 për Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës](#). Pasi Qeveria miratoi projektligjin më 31 tetor 2024, RrGK dërgoi “[Analizën Gjinore të Projektbuxhetit të vitit 2025 me rekomandime për Kuvendin e Kosovës](#)”, duke kërkuar nga të gjithë deputetët e Kuvendit që ta ndryshojnë dhe plotësojnë projektligjin në mënyrë që ai të adresojë disa nevoja prioritare të grave, burrave, vajzave dhe djemve, të cilat janë përshkruar në analizë

Qeveria nuk ka publikuar aneksat buxhetore që MFPT kërkon që çdo organizatë buxhetore (p.sh., ministritë dhe komunat) t'i përgatisë, sipas Qarkores Buxhetore. [Ligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025](#) nuk u shoqërua me një deklaratë gjinore të publikuar, e cila do të shpjegonte se si buxheti kontribuon në barazinë gjinore, edhe pse kjo do të ishte e rëndësishme, duke pasur parasysh se Kosova përdor buxhetimin e ndarë sipas zërave. Po ashtu, nuk është e qartë nëse buxheti është krijuar në bazë të analizës gjinore. Prandaj, bazuar vetëm në Ligjin për Buxhetin, për qytetarët mbetet e paqartë se si do të kontribuojë buxheti në arritjen e qëllimeve të Kosovës për avancimin e barazisë gjinore. Për më tepër, pasi këto anekse nuk janë publikuar, qytetarët nuk mund t'i analizojnë ato për të vlerësuar nëse ato përmbushin në mënyrë adekuate nevojat prioritare.



Një përmbledhje e trendeve dhe alokimeve buxhetore.

Qeveria ka planifikuar që shpenzimet totale buxhetore për vitin 2025 të arrijnë rreth 3.6 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 8.8%, ose rreth 293.2 milionë euro më shumë krahasuar me vitin 2024. Kategoria e pagave dhe mëditjeve ka një rritje prej rreth 111.5 milionë euro (14%). Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me rreth 17 milionë euro (4%), ndërsa subvencionet dhe transferet janë rritur me rreth 94 milionë euro (9%). Investimet kapitale janë rritur me rreth 72 milionë euro (8%). Edhe shërbimet komunale kanë pësuar një rritje prej 571 mijë euro (2%), ndërsa kategoria e rezervave ka pësuar një ulje prej rreth 6 milionë euro (60%). Nga alokimet buxhetore, 78% janë destinuar për nivelin qendror dhe 22% për nivelin komunal.⁸ Ka pasur pak ndryshime krahasuar me vitin 2024, kur niveli komunal duhej të merrte 23% të alokimeve buxhetore.



Granti i Përgjithshëm⁹ është rritur me 7% në vitin 2025 krahasuar me 2024, ndërsa Granti Specifik për Arsim¹⁰ është rritur me 4%. Financimi për Shërbime Rezidenciale ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 33% në vitin 2025. Nga ana tjetër, nuk ka pasur ndryshime në Grantin Specifik për Shëndetësi¹¹, Financimin për Shëndetësinë Dytësore dhe Grantin për Kryeqytetin – Prishtinë. Financimi për Obiliqin për adresimin e ndotjes së shkaktuar nga termocentrali është ulur me 4%.

⁸ Aneksi 3. Ndarjet Buxhetore për Nivelin Qendror dhe Nivelin Lokal për vitet 2024 dhe 2025.

⁹ Kuvendi i Kosovës, [Ligji nr. 03/ L- 049 për financat e pushtetit lokal Local Government Finance](#), Neni 24. Granti i Përgjithshëm është një shumë e cila i ndahet një komune dhe e cila mund të përdoret nga komuna për çfarëdo qëllimi që ndërlidhet me kompetencat e saj. Ky grant llogaritet në bazë të madhësisë së popullsisë, përfaqësimit të pakicave, sipërfaqes komunale dhe përfshin një rregullim të shumës së përgjithshme (paushall) për komunat më të vogla.

¹⁰ Po aty, Neni 25.4. Granti Specifik për Arsim llogaritet në bazë të regjistrimit të nxënësve, numrit të normalizuar të mësuesve dhe faktorëve me rëndësi, duke përfshirë nevojat e veçanta, vendndodhjen dhe përfaqësimin e pakicave.

¹¹ Kuvendi i Kosovës, [Ligji nr. 03/ L- 049 për financat e pushtetit lokal](#), Neni 25.5. Granti Specifik për Shëndetësi llogaritet në bazë të popullsisë, duke marrë parasysh moshën, gjininë, numrin e të moshuarve dhe nevojat e veçanta të kujdesit shëndetësor.

Përkushtimi ndaj prioriteteve për barazinë gjinore në buxhetin e vitit 2025

Në këtë seksion, së pari shqyrtohet deri në çfarë mase [Ligji për Buxhetin 2025](#) integron aspektet e barazisë gjinore. Më pas vlerësohet përkushtimi i tij ndaj nevojave prioritare për avancimin e barazisë gjinore, të cilat nevoja janë identifikuar nga RrGK, anëtarët dhe partnerët e saj, bazuar në hulumtime dhe dëshmi. Këto rekomandime i janë dorëzuar Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit në vitin 2024.

Financimi për Barazinë Gjinore

Buxheti i vitit 2025 nuk përmban asnjë analizë të nevojave të ndryshme potenciale të grave dhe burrave, duke përfshirë individë nga moshat, përkatësitë entike, aftësitë dhe vendndodhjet gjeografike të ndryshme. Po ashtu, nuk shoqërohet me një deklaratë buxhetore gjinore që do të shpjegonte se si shpenzimet do të kontribuojnë në barazinë gjinore. Si pasojë, është e vështirë të kuptohen nevojat e ndryshme dhe se si buxheti synon t'i adresojë ato ose të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore.

Një linjë buxhetore që lidhet drejtpërdrejt me avancimin e barazisë gjinore është për Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGj), me një total prej 380,230 € për vitin 2025. Krahasuar me 368,912 € në vitin 2024, kjo reflekton një rritje prej 3% në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje. Megjithatë, numri i punëtorëve nuk ka pësuar ndryshime. Disa komuna kanë linjën buxhetore nën paga dhe mëditje për zyrtarin/en për barazi gjinore, i/e cili/a është përgjegjës/e për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal, integrimin gjinor të politikave lokale, rritjen e vetëdijes për barazinë gjinore dhe zbatimin e detyrimeve të tjera ligjore të përshkruara në [Programin për Barazi Gjinore](#) dhe planet e veprimit për barazi gjinore në nivelet kombëtare dhe komunale. Kjo linjë buxhetore, e titulluar “Çështjet Gjinore”, ekziston vetëm në 42% të komunave. Në përgjithësi, shpenzimet totale për këtë linjë buxhetore janë rritur me 10%,¹² dhe shuma mesatare e buxhetuar për komunë është 19,947 €. Të gjitha komunat (38) kanë linjën buxhetore për “Çështjet Gjinore”, me një total prej 757,988 €. Megjithatë, njëzet e dy (22) komuna nuk kanë ndarë buxhet për këtë qëllim dhe linja përkatëse mbetet bosh.

Adresimi i Dhunës me Bazë Gjinore

Ligji për Buxhetin për vitin 2025 ka rritur ndarjet buxhetore për shpenzimet bazë për strehimoret për viktimat e dhunës në familje me 67% (1 milion €) krahasuar me vitin 2024, duke e çuar shumën totale në 2.5 milion €. Buxheti gjithashtu përfshin planet për ndërtimin e një qendre emergjente për mbrojtjen e fëmijëve në Nashec, e cila do të përfundojë deri në vitin 2027. Për më tepër, buxheti për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave është rritur me 128,776 € (31%) krahasuar me vitin 2024, sipas rekomandimeve të RrGK-së. Numri i punëtorëve gjithashtu është rritur me 28% (10 punëtorë shtesë), duke arritur gjithsej 46 punëtorë. Megjithatë, nuk ka informacion në lidhje me pozitat e këtyre punëtorëve të ri. Sigurimi i burimeve të duhura njerëzore kërkon personel të kualifikuar, kompensim të drejtë dhe trajnim të nevojshëm për mbështetje efektive të viktimave dhe promovimin e barazisë gjinore, çka mund të kontribuojnë në përmirësimin e mbrojtjes së të mbijetuarëve të dhunës me bazë gjinore. Pavarësisht se këto shpenzime përfaqësojnë përmirësime dhe janë të rëndësishme për avancimin e barazisë gjinore, Buxheti i vitit 2025 nuk adreson disa shpenzime të parapara nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), të cilën Kosova e ka miratuar në Kushtetutën e saj, përfshirë:

- **Qendrën e referimit të rasteve të dhunës seksuale dhe Qendrën për viktimat e përdhunimit**, siç kërkohet nga Neni 25 i Konventës së Stambollit për trajtimin e të mbijetuarëve të dhunës seksuale.
- **Linjën telefonike për ndihmë**, edhe pse kjo ishte parashikuar nga [Protokolli i ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#). Qeveria ka miratuar [“Udhëzimin Administrativ \(GRK\) – Nr. 01/2025 për Linjën Telefonike të Emergjencës për Viktimat e Dhunës në Familje”](#). Megjithatë, nuk është ndarë buxhet për këtë shërbim. [Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave](#) parashikon që linja për ndihmë të vendoset deri në fund të vitit 2026. Sipas

¹² Shih Aneksin 2.

Udhëzimit Administrativ, buxheti për linjën telefonike për ndihmë do të sigurohet nga Ministria e Drejtësisë.

- **Mekanizmat Koordinues Komunalë** për përmirësimin e menaxhimit të rasteve: Qeveria ka miratuar [Rregulloren \(GRK\) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore](#). Megjithatë, Ligji për Buxhetin nuk përmban informacione për ndarjen e mjeteve për funksionimin e këtij mekaniizmi
- **Punëtorët socialë të kualifikuar shitesë:** Buxheti i mjaftueshëm për të punësuar të paktën dy punëtorë socialë shitesë për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në çdo komunë dhe katër në Prishtinë, në përputhje me përgjegjësitë institucionale në [Protokollin e ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#), nuk është përfshirë në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëdijtje të Qeverisë, si pjesë e Grantit të qeverisë për shërbimet sociale. Këto pozita janë thelbësore për zbatimin e kornizës së re ligjore, parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e të mbijetuarve, kryesisht grave dhe fëmijëve.
- **Mbështetjen për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës:** Edhe pse buxheti i vitit 2024 përfshinte një linjë të veçantë buxhetore për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, kjo linjë buxhetore nuk figuron qartë në buxhetin e vitit 2025. Neni 36 i Ligjit për Buxhetin thotë se duhet të rriten përfitimet për kategoritë e luftës, përfshirë viktimat e dhunës seksuale.¹³ Megjithatë, është e paqartë se në cilën linjë buxhetore është realizuar kjo rritje. Një Deklaratë e Buxhetit Gjinnor mund të ndihmojë në sqarimin e kësaj.
- **Strehimorën për personat LGBTIQ+ (lezbike, homoseksuale, biseksuale, transgjinnorë, queer, interseksuale dhe asekssuale):** Edhe pse Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave parasheh “Ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe ato të strehimit për grupe të veçanta (djem dhe burra viktimat të dhunës në familje, persona LGBTI, etj.)”, as Ministria e Drejtësisë dhe as Komuna e Prishtinës nuk kanë ndarë këtë buxhet.¹⁴ Edhe pse Komuna e Prishtinës kishte ndarë një buxhet në vitin 2022,¹⁵ kjo strehimore nuk është ndërtuar ende .
- **Teknologjinë e monitorimit elektronik:** Qeveria e Kosovës ka lansuar mekanizmin e monitorimit elektronik në dhjetor 2024 për ndjekjen e individëve të dyshuar për dhunë me bazë gjinore dhe dhunë në familje. Megjithatë, zbatimi i [Ligjit Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilave u kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës](#), mbetet i paplotë. Infrastruktura e nevojshme për monitorimin elektronik, përfshirë pajisjet dhe sistemet e dedikuara, është ende në zhvillim. Si rezultat, asnjë urdhër mbikëqyrjeje elektronike të lëshuar nga gjykata nuk është zbatuar deri tani. Për më tepër, Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk ka ndarë mjete për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve të etiketimit elektronik, përfshirë byzylykët elektronikë. Këto janë jashtëzakonisht të rëndësishme për rritjen e mbrojtjes së të mbijetuarve dhe parandalimin e shkeljeve të përsëritura, duke siguruar që autorët të respektojnë urdhrat e ndalimit.

Financimi Adekuat i Skemës së Asistencës Personale

Buxheti i vitit 2025 nuk merr parasysh pagën minimale dhe [orët aktuale që kërkohen për asistentët personale që ofrojnë ndihmë për personat me aftësi të kufizuara](#). Kjo çon në shkeljen e të drejtave të punës së asistentëve personale, të cilët aktualisht paguhen më pak se paga minimale. Ka një nevojë urgjente për të rritur buxhetin e alokuar për asistentët personale të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë (PTTP), i cili aktualisht është vetëm 150 € në muaj, si dhe për të verbërit, për të cilët është ndarë një shumë prej 125 €, në mënyrë që kjo të përputhet të paktën me pagën minimale (aktualisht 350

¹³ Neni 36: Rritja e përfitimeve për kategoritë e luftës: Qeveria autorizohet që, me vendim, të përditësojë tabelën në aneksin 1 të [Ligjit nr. 04/L-054](#)

[Për Statusin Dhe Të Drejtat E Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve Të Ushtrisë Çlirimtare Të Kosovës, Viktimave Civile Dhe Familjeve Të Tyre](#), të ndryshuar dhe plotësuar me [Ligjin nr. 04/L-172](#), për rritjen e përfitimeve për këto kategori.

¹⁴ Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026), Objektivi specifik: Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për mbështetje për viktimat/të mbijetuarit nga të gjitha grupet dhe fëmijët viktimat dhe dëshmitarë të dhunës. Treguesi: Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, të zgjeruara dhe të përforcuara, të kategorizuara sipas llojit të shërbimit, grupit përfitues dhe veçorive të tyre.

¹⁵ Komuna e Prishtinës, Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024: Linja Buxhetore “Ndërtimi i Strehimoreve për komunitetin LGBTI”.

€), ose idealisht, me pagën mesatare (521 €). Asistentët personalë shpesh punojnë më shumë se tetë orë në ditë, por nuk përfitojnë pension. Kjo përbën një shkelje të të drejtave të tyre të punës sipas Ligjit të Punës. Gratë janë më të pranishme në mesin e asistentëve personalë, dhe adresimi i kësaj çështje mund të ndihmojë përmirësimin e kushteve të jetesës për asistentët personalë dhe për gratë (dhe burrat) që kujdesen për ta. Duke marrë parasysh se deri në dhjetor 2024, në Kosovë janë 3,093 persona me PTTP dhe 1,854 të verbër, kostoja e përgjithshme e mundshme do të arrijë në 18,864,072 € nëse llogaritet me pagën minimale, ose 30,928,644 € nëse përdoret paga mesatare.

Buxheti i vitit 2025 përfshin një rritje të buxhetit për disa kategori personash me aftësi të kufizuara.¹⁶ Buxheti për PTTP ka një alokim prej rreth 15 milion €, duke reflektuar një rritje prej rreth 4.1 milion € (36%). Për personat e verbër, buxheti është 5.9 milion €, duke shënuar një rritje prej rreth 612,960 € (12%). Megjithatë, mbetet e paqartë nëse këto linja buxhetore mbështesin asistentët personalë për personat me aftësi të kufizuara, pasi nuk ka një ndarje specifike buxhetore për këtë qëllim. Po ashtu, nuk ofrohen të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit e këtyre fondeve, megjithëse ato mund të jenë të përfshira në deklaratën buxhetore gjinore.

Financimi adekuat i kujdesit për fëmijët

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka një buxhet prej 98,963,750 €. Megjithatë, investimet kapitale në arsimin parashkollor mbeten të kufizuara dhe të paqarta nëpër komuna. Edhe pse 35 nga 38 komuna (92%) kanë ndarë linja buxhetore për arsimin parashkollor, me një vlerë të përgjithshme prej 22 milionë eurosh, investimet kapitale të financuara nga të hyrat vetanake janë të ulëta, duke arritur vetëm 700,000 €.¹⁷ Një shtesë prej 105,550 € vjen nga një grant i përbashkët komunal dhe qeveritar, ndërsa 610,000 € ndahen drejtpërdrejt nga grantet qeveritare. Këto të dhëna nxjerrin në pah një hendek të theksuar ndërmjet zotimeve në politika dhe nivelit real të investimeve në infrastrukturën e arsimit në fëmijëri të hershme.

Nevojiten alokime më të mëdha buxhetore për të përmbushur zotimet e përcaktuara në [Strategjinë Kombëtare për Zhvillim](#) dhe [objektivat](#) e të Barcelonës të BE-së. Rritja e qasjes në kujdesin publik për fëmijët, veçanërisht në zonat rurale, është thelbësore për të mundësuar përfshirjen e më shumë grave në tregun e punës dhe për të kthyer punën e papaguar të kujdesit në punësim formal dhe të paguar. RrGK ka vlerësuar se zgjerimi i [opsioneve për kujdesin ndaj fëmijëve mund të krijojë rreth 9,899 vende të reja pune vetëm në këtë sektor](#).

Ekonomia joformale dhe avancimi i të drejtave të punëtorëve


RrGK ka rekomanduar më parë rritjen e numrit të inspektorëve të punës dhe trajnimin e tyre për të identifikuar dhe trajtuar më mirë rastet e diskriminimit gjinor. Në [Programin e Qeverisë 2021–2025](#), mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e numrit të inspektorëve të punës janë vendosur si prioritet kryesor. Megjithatë, këto zotime nuk pasqyrohen në buxhetin e vitit 2025. Teksa buxheti për Inspektoratin e Punës është rritur me 21%, numri i personelit është ulur me 10%.

Sipas [Strategjisë së Zhvillimit të Inspektoratit të Punës 2023–2025](#), objektivi strategjik 1: Reformimi i Strukturës së Inspektoratit të Punës përfshin objektivin për vitin 2025: “Struktura e re e Inspektoratit të Punës është miratuar, personeli shtesë i kërkuar është punësuar dhe janë miratuar procedurat e brendshme”. Ky objektiv nuk po realizohet, pasi Ligji i Buxhetit 2025 pasqyron një numër më të ulët të personelit.

Kostoja e vlerësuar për arritjen e vetëm objektivave strategjike është 1.5 milionë euro për vitin 2025, duke përfshirë shpenzimet e tjera të nevojshme si administrata, pagat dhe kostot operative. Buxheti i përgjithshëm i alokuar për Inspektoratin e Punës për vitin 2025 është 1.6 milionë euro, që

¹⁶ Në kategorinë “Pensionet për personat me aftësi të kufizuara”, janë ndarë rreth 32 milionë euro, që përfaqëson një rritje prej afro 2.9 milionë euro (10%) krahasuar me vitin 2024. Për “Skemën për fëmijët me aftësi të kufizuara të moshës 1–18 vjeç”, buxheti kap shifrën e rreth 5.7 milionë eurove, me një rritje prej rreth 1.4 milionë euro (33%). Ndërkohë, për kategorinë “Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta” janë ndarë 2.9 milionë euro, që nënkupton një rritje prej afërsisht 48,321 eurosh (2%). Për Institutin Special dhe shtëpinë për fëmijët me aftësi të kufizuara, buxheti për vitin 2025 është rreth 2.1 milionë euro, që përfaqëson një ulje të ndjeshme prej rreth 1.6 milionë eurosh (43%).

¹⁷ See Annex 4



tregon se mund të ketë burime të pamjaftueshme për të mbuluar zbatimin e strategjisë dhe nevojat e vazhdueshme operative.

Më tej, Shtylla II e KASH: Zhvillimi i Barabartë Njerëzor, në fushën e politikave të Tregut të Punës dhe Punësimit, ka një objektivi të titulluar: “Përmirësimi i kushteve të punës dhe puna e denjë”. Kjo përfshin objektivin 3.2: “Reformimi i Inspektoratit të Punës”. Reduktimi i personelit minon këto synime. Ky reduktim vë punëtorët në rrezik në një kohë kur nevojiten më shumë inspektorë, jo më pak, për të adresuar [diskriminimin gjinor, ngacmimin seksual në punë](#) dhe [joformalitetin, që duket se prekin gratë në mënyrë disproporcionale](#).

Adresimi i Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Që nga viti 2018, [Kosova është zotuar](#) në realizimin e [Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm \(OZHQ\)](#) dhe përafrimin e politikave të saj me Agjendën 2030, duke përfshirë OZHQ5 për barazinë gjinore. Në përputhje me këtë zotim, [Qeveria, në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, themeloi Fondin e Përbashkët Përsheptues për OZHQ-të, me një kontribut fillestar prej 200,000 € dhe një mekanizëm që përputhet me 20% të çdo kontributi shtesë nga donatorët](#). Ndërkohë, ky është një hap i rëndësishëm drejt adresimit të prioritetëve të zhvillimit të përgjegjshëm gjinor, si ulja e varfërisë, energjia e rinovueshme, transformimi digjital dhe reforma arsimore. Megjithatë, Buxheti Vjetor 2025 nuk përmend dhe nuk alokon mjete për këtë Fond për OZHQ. Mungesa e një linje të qartë buxhetore ngre shqetësime për operacionalizimin e zotimeve të Kosovës ndaj OZHQ-ve dhe aftësinë e saj për të siguruar financim të qëndrueshëm dhe transparent për këto qëllime, përfshirë OZHQ 5. Që nga [publikimi i pikave kyçe të progresit për OZHQ-të në vitin 2018](#), as Qeveria dhe as Kuvendi i Kosovës nuk kanë publikuar raporte pasuese apo ndonjë informacion mbi zbatimin e OZHQ-ve. Mungesa e raportimit të rregullt kontribuon në shqetësimet për transparencën, monitorimin dhe zotimin institucional në lidhje me Agjendën 2030, duke përfshirë ndikimet në barazinë gjinore.

Sa është KASH i ndjeshëm ndaj aspektit gjinor?

Në përgjithësi, KASH 2025–2027 përmend termin “gjin” tetë herë në 114 faqe, kryesisht në kontekstin e dhunës me bazë gjinore, buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe, në mënyrë më të gjerë, avancimit të perspektivës gjinore. Gratë përmenden 14 herë, në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së tyre në pozita vendimmarrëse në administratën publike, përmirësimin e aksesit në tregun e punës, trajtimin e dhunës ndaj grave, vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fuqizimin e tyre. KASH pranon ekzistencën e pabarësive gjinore dhe thekson rëndësinë e fuqizimit ekonomik të grave, përfshirë mbështetjen për biznese jo-prodhuese të udhëhequra nga gratë, si pjesë e objektive për rritje gjithëpërfshirëse. Iniciativat për punësim që synojnë gratë dhe familjet pa anëtarë të punësuar, si dhe platforma “SuperPuna” për të rinjtë, tregojnë një përpjekje për të adresuar sfidat specifike të punësimit gjinor. Ndërkohë, burrat, djemtë dhe vajzat nuk përmenden në mënyrë të veçantë. Dokumenti përmban pak të dhëna të ndara sipas gjinisë, të cilat janë thelbësore për të kuptuar dhe adresuar më mirë nevojat. KASH nuk reflekton se si politikat fiskale dhe investimet publike ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek gratë dhe burrat.

Në përgjithësi, dokumentit i mungojnë objektivat, treguesit, pikënisjet dhe qëllimet specifike dhe të matshme. Pa tregues të qartë dhe objektiva të lidhura me ndarjet e planifikuara buxhetore, ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë e vështirë të monitorohet dhe vlerësohet se si alokimet po kontribuojnë në arritjen e prioritetëve strategjike të KASH-it, përfshirë ato që lidhen me barazinë gjinore.

KASH ka katër shtylla: zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, zhvillim të barabartë njerëzor, siguri dhe sundim të ligjit, dhe qeverisje të mirë. Çdo shtyllë ka prioritetet dhe drejtimet kryesore për zbatimin. Nënseksionet e mëposhtme shqyrtojnë secilën nga këto.

Zhvillimi Ekonomik i Qëndrueshëm

Avancimi i barazisë gjinore nuk është përfshirë si pjesë e asnjë prej prioritetëve dhe kahjeve të politikave për zbatimin në këtë shtyllë. Fushat e politikave përfshijnë mbështetje për zhvillimin e industrisë dhe bizneseve, bujqësinë, energjinë, transportin, komunikimin, mjedisin dhe planifikimin hapësinor. Ka mundësi për përfshirjen e fokusit në avancimin e barazisë gjinore në këto fusha politike, megjithëse kjo nuk është realizuar. Për shembull, analizat e fundit gjinore mbi [joformalitetin](#) dhe

[bujqësinë](#) ofrojnë të dhëna që mund të ndihmojnë në identifikimin e dallimeve midis grave dhe burrave dhe, si pasojë, të mundësojnë hapa konkretë nga qeveria për të trajtuar pabarazitë dhe kontribuar në zhvillimin ekonomik.

Zhvillimi i Barabartë Njerëzor

Kjo shtyllë e dytë përfshin fushat e politikave si Arsimi dhe Shkenca, Tregu i Punës dhe Punësimi, Shëndetësia, Kujdesi Social, Kultura dhe Sporti. Në mesin e këtyre fushave, qeveria ka identifikuar vetëm një prioritet që lidhet me barazinë gjinore. Në fushën e politikave të Tregut të Punës dhe Punësimi, ky prioritet synon rritjen e “pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në tregun e punës”. Udhëzimet për zbatimin e këtij prioriteti përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së grave në programet e punësimi, subvencionimin e projekteve të organizatave joqeveritare që synojnë fuqizimin e grave, rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara në programet e punësimi dhe zbatimin e programeve si Youth Guarantee dhe Generation Unlimited. Fushat e tjera të politikave mund të kishin përfshirë gjithashtu kahje që reflektojnë përgjegjshmërinë gjinore dhe synojnë adresimin e pabarazive gjinore. Për shembull, arsimi në fëmijërinë e hershme mund të kishte përqendruar vëmendjen në nevojën për të ndërtuar më shumë qendra për edukimin në fëmijërinë e hershme, duke përmbyshur zotimet e qeverisë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, pasi hulumtimet tregojnë se kjo mund të ofrojë mundësi për më shumë gra të përfshihen në fuqinë punëtore, [duke ofruar shërbime në fushën e kujdesit](#), të kontribuojnë në hapjen e vendeve të reja pune, veçanërisht për gratë, dhe të ndihmojnë në transformimin e normave gjinore.

Siguria dhe Sundimi i Ligjit

Shtylla e tretë përfshin fushat e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, sigurisë publike dhe drejtësisë. Qeveria ka identifikuar vetëm një prioritet që ndërlidhet me aspektin gjinor, duke u fokusuar në qasjen e duhur në drejtësi. Udhëzimet për zbatimin e këtij prioriteti përfshijnë plotësimin e kornizës ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën me bazë gjinore, forcimin e kapaciteteve të mekanizmave institucionalë për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera që burojnë nga legjislacioni përkatës. Po ashtu, përmirësimi i qasje së grave në pronë përmes zbatimit të masave afirmative është pjesë e këtij prioriteti. Fushat e tjera të politikave gjithashtu mund të kishin kontribuar në avancimin e barazisë gjinore në mbrojtje dhe siguri, veçanërisht në kuadër të zotimeve të Presidentes së Kosovës për përmirësimin e zbatimit të Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë, përmes punës në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë. Siguria publike gjithashtu duhet të marrë parasysh dallimet dhe pabarazitë gjinore.

Qeverisja e Mirë

Kjo shtyllë e katërt përfshin fushat e politikave të qeverisë dhe administratës publike, financave publike, politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Sa i përket aspektit gjinor, qeveria ka identifikuar dy drejtime. Në fushën e politikave të qeverisë dhe administratës publike, prioritet është “Rritja e efektivitetit të shërbimit publik dhe llogaridhënies në administratën publike”. Për zbatimin e këtij prioriteti, një nga masat e parashikuara është zbatimi i masave afirmative për rritjen e numrit të grave në pozita vendimmarrëse në nivel ekzekutiv. Në fushën e politikave të financave publike, prioritet është sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme. Për realizimin e këtij prioriteti, një nga drejtimet është buxhetimi gjinor në institucionet qendrore dhe lokale. Kështu, kjo shtyllë është mjaft e orientuar drejt çështjeve gjinore.

Rekomandime për KASH-in e Ardhshëm

Ky seksion përmbledh rekomandimet kryesore për integrimin e perspektives më të avancuar gjinore në secilën shtyllë dhe sektor të KASH-it të ardhshëm, duke u mbështetur në hulumtimet ekzistuese dhe mësimet e nxjerra nga kjo analizë e përshpjeguar gjinore e Buxhetit 2025 dhe KASH 2025-2027. Në përgjithësi, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, gjinia duhet të përfshihet në të gjitha fushat e politikave, duke integruar sistematikisht analizën gjinore që do të informojë objektivat, veprimet, treguesit, pikënisjent dhe objektivat përkatëse në të gjitha shtyllat e KASH-it.


Shtylla I: Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik

- Të sigurohet që e gjithë mbështetja për zhvillimin e industrisë dhe biznesit të përfshijë masa afirmative për të mbështetur bizneset e udhëhequra nga gratë, të cilat zakonisht përballen me kufizime shtesë.
- Të sigurohet që politikat dhe investimet bujqësore të mbështeten në një [analizë të plotë gjinore](#).
- **Të sigurohen investime në transport që janë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore dhe klimatike**, duke përfshirë përmirësimin e transportit publik, krijimin e trotuareve të qasshme dhe të sigurta, si dhe korsi të për biçikleta si pjesë e të gjitha projekteve të investimeve kapitale, përfshirë planifikimin hapësinor.
- **Të krijohen dhe të zbatohen masa të detyrueshme për transparencën e pagave**, duke kërkuar nga kompanitë që të publikojnë nivelet e pagave për pozitat e hapura dhe të kryejnë auditime të rregullta të pagave. Kjo mund të ndihmojë në zbardhjen dhe luftimin e hendekut gjinor të pagave, duke nxjerrë në pah pabarazitë në paga dhe duke fuqizuar punëtorët, veçanërisht gratë, për të negociuar kompensim të drejtë. Kjo do të përputhej me [Direktivën e BE-së për Transparencën e Pagave \(Direktiva \(BE\) 2023/970\)](#), e cila ka për qëllim luftimin e diskriminimit në paga dhe mbylljen e hendekut gjinor të pagave në të gjithë BE-në. Sipas kësaj Direktive, kompanitë janë të detyruara të ofrojnë informacion mbi pagat, të ndërmarrin masa korrigjuese nëse hendeuku i pagave gjinore është më i madh se 5%, dhe të sigurojnë kompensim për individët që kanë përjetuar diskriminim në paga. Ajo gjithashtu parashikon masa ndëshkuese, përfshirë gjoba, për punëdhënësit që nuk e respektojnë, duke e shndërruar transparencën në një mjet për promovimin e pagave të barabarta dhe fuqizimin e punëtorëve, veçanërisht grave, për të kërkuar kompensim të drejtë. Ky rekomandim mbështet prioritetin e KASH-it 'Zhvillimi i industrisë drejt produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar dhe drejt një ekonomie rrethore', duke kontribuar në mënyrë të veçantë në drejtimin e zbatimit të 'Gjenerimit të punësimit gjithëpërfshirës dhe më të mirë', si pjesë e masave të tjera për punësimin, mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimin.
- [Të sigurohet sigurimi shëndetësor, lehtësimi i përkohshëm i tatimit mbi të ardhurat](#) dhe subvencione për të mbështetur kalimin nga [punësimi joformal në atë formal](#).

Shtylla II: Zhvillimi i Barabartë Njerëzor

Adresimi i qasjes në kujdes për fëmijët

- MASHTI duhet të investojë drejtpërdrejt në qendra dhe të inkurajojë komunat që të buxhetojnë për ngritjen e **më shumë qendrave publike të kujdesit ndaj fëmijëve dhe kopshteve me çmime më të përballueshme**. Duke vendosur caqe konkrete dhe [alokime buxhetore, të bazuara në vlerësimet gjithëpërfshirëse të nevojave, komunat mund të adresojnë shkallën e lartë të papunësisë dhe mungesës së angazhimit](#). RrGK ka vlerësuar se [zgjerimi i opsioneve të kujdesit ndaj fëmijëve mund të krijojë rreth 9,899 vende të reja pune](#). Më tej, kjo do t'u mundësojë më shumë grave të punojnë dhe të përmirësojnë rezultatet arsimore në përputhje me objektivat e [BE-së të Barcelonës](#). Buxhetimi për rritjen e disponueshmërisë së shërbimeve të kujdesit me çmim të përballueshëm, [veçanërisht në zonat rurale, është thelbësor për transformimin e punës së papaguar të kujdesit në punësim me pagesë, angazhimin e më shumë grave në fuqinë punëtore dhe mbështetjen e arsimit transformues gjinor që në moshë të re](#). Qeveria është zotuar për këto investime në [Strategjinë Kombëtare për Zhvillim](#) dhe tani duhet të bëhen ndarjet buxhetore. MASHTI duhet të përqendrohet në rritjen e buxhetit ekzistues për ndihmën në krijimin dhe mirëmbajtjen e qendrave publike të kujdesit ndaj fëmijëve dhe kopshteve, si dhe të ofrojë stimuj të synuar dhe mundësi bashkëfinancimi për komunat. Edhe pse donatorët ndërkombëtarë, si Instrumenti i Para-anëtarësimit të BE-së (IPA), kanë mbështetur këto përpjekje në të kaluarën, progresi i qëndrueshëm kërkon financim të brendshëm dhe një planifikim buxhetor të qartë dhe të bazuar në rezultate në të gjitha nivelet e qeverisjes. Ky rekomandim mbështet drejtpërdrejt Prioritetin e KASH-it "Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin dhe kujdesin cilësor në fëmijërinë e hershme."



- Të rritet pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin dhe kujdesin cilësor në fëmijërinë së hershme (EKHF), të sigurohet integrimi i BPGj-së dhe analiza ndërthurës gjinore në proceset e planifikimit, buxhetimit dhe monitorimit.¹⁸ Më konkretisht:
 - Të ndahen mjete për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë përkatës (p.sh., Drejtoritë Komunale të Arsimit, Arsimi në fëmijërinë e hershme, komisioni i MASHTI, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe Inspektorati) në pedagogjinë e përgjegjshme gjinore (PPGj), mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, analizën dhe përdorimin e tyre për të informuar politikën.
 - Të alokohen buxhete për trajnim dhe angazhim aktiv të palëve të interesuara, duke përfshirë ekspertët gjinorë, ofruesit e shërbimeve EKF, organizatat për të drejtat e grave dhe Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës në zhvillimin e kurrikulave, sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat monitorues.
 - Të rriten investimet publike në infrastrukturën për Kujdesin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme që adresojnë nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe familjeve, duke përfshirë ato në zonat rurale, me aftësi të ndryshme fizike ose njohëse, prindërit që punojnë dhe grupet e pakicave gjuhësore. Kjo përfshin linjat buxhetore për asistentët e mësimdhënies, pajisjet ndihmëse, infrastrukturën e qasshme dhe mbështetjen ushqimore.
 - Të përfshihen komponentët e BPGj-së në Strategjinë e Arsimit, Planet e Veprimit dhe Buxhetet Vjetore, me linja të veçanta buxhetore për zbatimin e PPGJ-së, trajnimet transformuese gjinore, skemat sociale, strategjitë e rekrutimit dhe angazhimit të komunitetit.

Adresimi i punësimit, punës dhe të drejtave të punëtorëve

- Të vazhdohet me investime në tregun e punës dhe programet e punësimit, duke përdorur masa afirmative për përfshirjen e grave, veçanërisht grave të reja, nga grupe minoritare, nga zonat rurale dhe ato me aftësi të kufizuara, si grupe që janë veçanërisht të nën-përfaqësuar në fuqinë punëtore. Të investohet më shumë në kujdesin për fëmijët, kujdesin për të moshuarit dhe kujdesin për personat me aftësi të kufizuara, duke e transformuar punën e papaguar në punë të paguar, duke krijuar vende pune dhe duke u mundësuar më shumë grave të angazhohen në fuqinë punëtore.
- Të ndryshohet Ligji i Punës për të futur politika miqësore për familjen, në përputhje me Direktivën e BE-së për Balancimn e Punës dhe Jetës, dhe hulumtimin e RrGK [“Më shumë zgjedhje përmes politikave miqësore për familjen”](#), duke përfshirë pushimin e paguar të atësisë dhe pushimin prindëror individual dhe të patransferueshëm për të dy prindërit. Të krijohet urgjentisht një fond i financuar nga buxheti publik për pushimin e lehonisë, atësisë dhe pushimin prindëror, duke reduktuar barrën për punëdhënësit dhe duke promovuar prindërimin e barabartë gjinor.
- Të sigurohet ndarja e mjaftueshme buxhetore për zbatimin e plotë të Strategjisë Zhvillimore të Inspektoratit të Punës 2023–2025, duke rivendosur dhe rritur nivelet e personelit, në përputhje me 1.5 milionë euro të nevojshme për reformat strategjike. Kjo mbështet objektivin e Shtyllës II të KASH-it “Përmirësimi i kushteve të punës dhe puna e denjë” dhe është thelbësore për adresimin e joformalitetit, diskriminimit me bazë gjinore dhe ngacmimeve në vendin e punës

Sigurimi i kujdesit shëndetësor adekuat

- Të sigurohet buxhet i mjaftueshëm në mënyrë që të gjitha gratë të kenë qasje në shërbimet gjithëpërfshirëse të kujdesit shëndetësor riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar dhe kujdesin e sigurt për abortin.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të përditësojë dhe të publikojë listën zyrtare të sëmundjeve profesionale, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rreziqet shëndetësore që mund të lindin. Kjo do të sigurojë mbrojtje më të mirë të të drejtave të punëtorëve, do të mundësojë diagnozë dhe raportim më të saktë dhe do të informojë planifikimin e masave parandaluese dhe kompensuese brenda sektorëve të shëndetësisë dhe punës. Ky rekomandim mbështet prioritetin e KASH-it

¹⁸ RrGK, [Integrimi i qasjeve transformuese gjinore në edukimin në fëmijërinë e hershme, kurrikula dhe pedagogji](#) 2024

“Përmirësimi i kushteve të punës dhe punë e denjë,” duke kontribuar në mënyrë specifike në kahjen e zbatimit të “përmirësimit të sistemit strukturor të sigurisë dhe shëndetit në punë.”

Financimi adekuat i Skemës së Asistencës Personale

- Të rritet linja buxhetore për financimin e Skemës së Asistencës Personale, bazuar në kohën e nevojshme që asistentët personalë të ofrojnë ndihmë për personat me aftësi të kufizuara. Ky ndryshim pritet të kushtojë rreth 14,556,960 €, duke dyfishuar afërsisht kostot aktuale të vlerësuara. Të rritet gjithashtu buxheti i alokuar për asistentët personalë për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, aktualisht 150 € në muaj, si dhe për personat e verbër, aktualisht 125 € në muaj, në mënyrë që të përputhet së paku me pagën minimale (aktualisht 350 €).

Adresimi i dhunës me bazë gjinore

Në përputhje me prioritetet e KASH-it “Përmirësimi i synimit dhe i shpërndarjes së shërbimeve të mbrojtjes sociale” dhe “Qasje më e mirë në shërbimet sociale”, dhe për të përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ndërkombëtare të Kosovës sipas Konventës së Stambollit, si dhe për të siguruar qasje kuptimplote në mbrojtje dhe shërbime për të gjithë të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, qeveria – në veçanti Ministria e Drejtësisë dhe MFPT – duhet të ndërmarrin investime strategjike dhe të leverdishme nën programin e Shërbimeve Sociale në KASH-in e ardhshëm:

- Të ndahen mjete të dedikuara për funksionalizimin e plotë të **linjës telefonike të emergjencës**, siç parashihet me [Udhëzimin Administrativ \(GRK\) nr. 01/2025](#) dhe [Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#). Financimi duhet të mbulojë personelin, infrastrukturën, funksionimin 24/7 dhe mbulimin mbarëkombëtar. Kjo përputhet me përmirësimin e qasjes në shërbime dhe mbrojtjen e grupeve më të cënueshme.
- Të futet një linjë e re buxhetore për krijimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të **Qendrës së Referimit dhe Qendrës për viktimat e përdhunimit** për të mbijetuarat e dhunës seksuale. Këto qendra janë thelbësore për ofrimin e ndihmës së menjëhershme mjekësore, psikologjike dhe ligjore dhe për përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Konventës së Stambollit.
- Të ndahen mjete në kuadër Grantit të Qeverisë për Shërbime Sociale, Paga dhe Mëditje, për punësimin e **dy punëtorëve socialë** në secilën komunë për të adresuar rastet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje. Ky investim do të kushtonte rreth **444,000 € në vit për Qeverinë e Kosovës**, duke përfshirë nevojën që Komuna e Prishtinës – si komuna më e madhe – të angazhojë **katër punëtorë të tillë**. Kjo kërkesë duhet të përfshihet në buxhetet komunale për zbatimin e [Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#). Gjithashtu, si pjesë e këtij granti, “Qendrat për Punë Sociale duhet të krijojnë një **fond për raste emergjente** për nevojat e viktimave gjatë periudhës kur ato ndodhen në stacionin e policisë.¹⁹”
- Të sigurohet rifutja ose sqarimi i linjës buxhetore për të **mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë konfliktit**, e cila ishte e pranishme në vitin 2024, por nuk është qartë e identifikueshme në buxhetin e vitit 2025. Përfitimet për këtë grup duhet të mbrohen dhe të zgjerohen në përputhje me nenin 36 të Ligjit për Buxhetin dhe rekomandimet e shoqërisë civile dhe rrjeteve të të mbijetuarve.
- Të ndahen mjete për investime kapitale në formë të tokës, rinovimit apo ndërtimit të një **strehimoreje të dedikuar për të mbijetuarit LGBTQIA+**, siç parashihet në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare.
- Të sigurohet një ndarje specifike buxhetore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për **sistemet e mbikëqyrjes elektronike** (byzylyk, softuer, infrastrukturë monitorimi) me qëllim të zbatimit të Ligjit Nr. 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës. Ky investim është thelbësor për parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore

¹⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore](#).

Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile

- Deri më tani, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë mbështetur kryesisht nga financimi ndërkombëtar, veçanërisht për monitorim, hulumtime dhe avokim. Përballë shkurtimeve të papritura të mbështetjes së jashtme financiare në vitin 2025, Qeveria duhet të marrë përgjegjësinë për mbështetjen e shoqërisë civile në Kosovë, duke dëshmuar përkushtimin e saj ndaj demokracisë, qeverisjes së mirë dhe të drejtave të njeriut. KASH-i i ardhshëm dhe Buxheti i vitit 2026 duhet të përfshijnë një linjë të përhershme dhe të mjaftueshme buxhetore për mbështetjen financiare të shoqërisë civile në kuadër të secilës ministri dhe komune, me theks të veçantë për ABGj. Ky financim duhet të përkrahë iniciativat e OShC-ve që synojnë avancimin e barazisë gjinore, në përputhje me [Programin për Barazi Gjinore](#). Mbështetja financiare e Qeverisë mund të përfshijë hulumtime, rritjen e ndërgjegjësimit, avokimin, zhvillimin e politikave dhe monitorimin e punës së institucioneve. Këto burime duhet të ndahen bazuar në udhëzime të hartuara në konsultim të ngushtë me OShC-të, për të garantuar drejtësi, transparencë dhe pavarësi të shoqërisë civile. Krijimi i një mbështetjeje të tillë të vazhdueshme do të përmirësonte qëndrueshmërinë afatgjatë të OShC-ve, të cilat mund të luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e Qeverisë në avancimin e barazisë gjinore. Ky rekomandim është në përputhje me drejtimin e zbatimit të KASH-it për “Subvencionimin e projekteve të OJQ-ve që synojnë fuqizimin e grave në shoqëri”.

Shtylla IV: Qeverisja e mirë

Adresimi i mangësive në llogaridhënien e buxhetit

- Të investohet në institucionalizimin e BPGj-së në **sistemet e menaxhimit financiar publik, përmes reformave të politikave dhe digjitalizimit**, në përputhje me zotimet ligjore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Kjo përfshin Kornizën Suplementare për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore ([PEFA GRPFM](#)) dhe treguesin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 5.c.1 ([OZHQ 5.c.1 i OKB-së](#)). Të përfshihet angazhimi për BPGj-në në Ligjin e ardhshëm për Financat Publike dhe të sigurohet që kërkesat për analizë gjinore, tregues, pikënisje dhe objektiva për avancimin e barazisë gjinore të përfshihen në sistemet e menaxhimit financiar digjital, duke lidhur ato me shpenzimet e planifikuara buxhetore.
- Të investohet në përditësimin e faqeve të internetit të komunave dhe ministrive, për të mundësuar **publikimin e anekseve për barazi gjinore** dhe deklaratave buxhetore gjinore, duke kontribuar në transparencën dhe llogaridhënien.
- Të përgatitet dhe të publikohet një deklaratë buxhetore gjinore që do të shoqërojë Ligjin për Buxhetin 2026, për të sqaruar se si shpenzimet do të kontribuojnë në barazinë gjinore. Kjo është e nevojshme, duke pasur parasysh se buxheti aktual në Kosovë nuk tregon në mënyrë të qartë se si shpenzimet do të ndikojnë në avancimin e barazisë gjinore.

Këto rekomandime mbështesin prioritetin e KASH-it “Sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme”, duke kontribuar në mënyrë të veçantë në zbatimin e “Buxhetimit gjinor në institucionet qendrore dhe lokale.”

Sigurimi i politikave tatimore gjithëpërfshirëse

- **Të ulet ose eliminohet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)** për produktet menstruale.
- Të zbatohen [nasa progresive tatimore](#) që ri-shpërndajnë pasurinë dhe zvogëlojnë pabarazinë e të ardhurave, nga të cilat përfitojnë gratë, të cilat shpesh janë të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale mes [individëve me të ardhura të ulëta](#).
- **Të futen stimuj dhe përjashtime tatimore për të inkurajuar sipërmarrjen tek gratë**, duke përfshirë norma të ulura tatimesh për bizneset e vogla në pronësi të grave ose të udhëhequra nga gratë.
- Të integrohen **parimet e BPGj-së në formulimin dhe zbatimin e politikave tatimore**, për të siguruar që të ardhurat tatimore të mbliidhen në një mënyrë që promovon barazinë gjinore dhe të drejtat e grave.

- Të ketë konsultime me organizatat e grave, grupet e shoqërisë civile dhe ekspertët gjinorë gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave tatimore, për të siguruar që ato po i adresojnë nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave.

Këto rekomandime mbështesin prioritetin e KASH-it “Sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme”, duke kontribuar në veçanti në zbatimin e “Përmirësimit të mbledhjes së të hyrave dhe matjes së hendekut tatimor” dhe “Shpenzimeve tatimore të qëndrueshme”.

Aneksi 1. Shembull i përmirësimit të BPGj-së në KASH

Një mangësi e madhe e KASH-it është mungesa e objektivave të qarta, treguesve, pikënisjeve dhe qëllimeve, përfshirë ato për matjen e progresit në avancimin e barazisë gjinore. Si pasojë, progresi drejt arritjes së objektivave të tij, lidhur me shpenzimet, nuk mund të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë transparente. Duke u bazuar në praktikat më të mira të identifikuar nga ekspertët e BPGj, ky dokument mund të përfitojë nga përfshirja e këtij informacioni. Ky aneks ofron një shembull të mundshëm të mënyrës si mund të përmirësohet ky proces, bazuar në publikimet e mëparshme të RrGK-së.²⁰

Pagat dhe mëditjet

Niveli i pagës	Numri total i personelit	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burra	# dhe % e Women grave	Shuma e shpenzuar për gra	Shuma totale e shpenzuar
201–400	1	0 (0%)	€0 (0%)	1 (100%)	€3,856 (100%)	€3,856
401–600	15	9 (60%)	€51,395 (60%)	6 (40%)	€34,292 (40%)	€85,687
600+	10	10 (59%)	€55,252 (57%)	7 (41%)	€41,645 (43%)	€96,897

Mëditjet për udhëtimet zyrtare

Rajon	Gra	Bura	Gjithsej
Udhëtimet zyrtare kombëtare	86 (33%)	171 (67%)	257
Udhëtimet zyrtare ndërkombëtare	54 (30%)	124 (70%)	178
Gjithsej	140	295	435

Mëditjet për udhëtimet zyrtare


Kategoria	Gra	Burra	Gjithsej
# i zyrtarëve	48 (37%)	82 (63%)	130
Shuma e shpenzuar	€28,151 (29%)	€68,596 (71%)	€96,747

Pasi të jenë identifikuar pabarazitë përmes analizës gjinore, ato mund të shërbejnë si bazë për përcaktimin e objektivave për përmirësim, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Objektivi	Treguesi	Pika referuese (2016)	Qëllimi (2019)
Përmirësimi i balancës gjinore në përbërjen e punonjësve, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.	% e punonjësve dhe vendimmarrësve të MMPH-së që janë gra	37.8% e punonjësve janë gra, prej të cilave 22% janë në role vendimmarrëse	Të paktën 45% e personelit duhet të jenë gra, me synim arritjen e barazisë 50%
Përmirësimi i balancës gjinore ndër punonjësit që ndjekin trajnime dhe ngjarje ndërkombëtare.	% e shpenzimeve për trajnime dhe udhëtime/pjesëmarrësve që janë gra	36.9% e udhëtarëve ishin gra; 29.1% e mjeteve për udhëtim	40%+ grave të jenë pjesëmarrëse në trajnime dhe udhëtime, si dhe të përfitojnë fonde
Përmirësimi i përfshirjes së grave në konsultimet publike për shpenzimet kapitale.	% e grave mes pjesëmarrësve në konsultimet publike	<10% pjesëmarrja e grave në konsultime publike	30% e grave të jenë pjesëmarrëse në konsultime deri në vitin 2019; progres në 50% deri në vitin 2024
Përmirësimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në procesin e prokurimit.	% e kontratave që përfshijnë kriteret e përgjegjshme gjinore	0% e kontratave përfshijnë kriteret gjinore	30% e kontratave të reja me kriteret e përgjegjshme gjinore

²⁰ Për shembuj të tjerë, shih publikimet e ndryshme të RrGK-së në lidhje me BPGj-në në [faqen e internetit të RrGK-së](#), të cilat ofrojnë shembuj më specifikë për sektorë të ndryshëm, siç është [Buxheti për një mjedis më të mirë: analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Mjedisit të Planifikimit Hapësinor](#).

Objekti	Treguesi	Pika referuese (2016)	Qëllimi (2019)
Përmirësimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave të ndara sipas gjinisë, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore	Përfshirja e të dhënave të ndara sipas gjinisë në buxhete dhe në KASH	Të dhënat nuk mbledhen dhe raportohet në mënyrë sistematike	Departamentet të mbledhin dhe përdorin 100% të dhëna të ndara sipas gjinisë



Aneksi 2. Buxhetet e komunave për barazi gjinore (Linjat buxhetore për çështje gjinore)

Komuna	Buxheti për Çështjet Gjinore 2024	Buxheti për Çështjet Gjinore 2025	Dallimi	%	Numri i punëtorëve 2024	Numri i punëtorëve 2025
Deçan						
Dragash	11,200 €	10,808 €	-392 €	-4%	1	1
Ferizaj						
Fushë Kosovë	24,911 €	28,032 €	3,121 €	13%	2	2
Gjakovë						
Gjilan						
Drenas						
Graçanicë	11,760 €	12,142 €	382 €	3%	1	1
Han i Elezit						
Istog	29,535 €	30,641 €	1,106 €	4%	3	3
Junik						
Kaçanik	12,248 €	16,269 €	4,021 €	33%	1	1
Kamenicë	15,501 €	14,722 €	-779 €	-5%	1	1
Klinë	13,393 €	13,893 €	500 €	4%	1	1
Klllokot						
Leposaviq						
Lipjan						
Malishevë	19,621 €	21,417 €	1,796 €	9%	1	1
Mamushë						
Mitrovica Veriore						
Mitrovicë	44,380 €	46,500 €	2,120 €	5%	2	2
Novobërdë	13,600 €	13,339 €	-261 €	-2%	1	1
Obiliq						
Partesh	7,000 €	9,000 €	2,000 €	29%	1	1
Pejë	13,037 €	27,482 €	14,445 €	111%	1	1
Podujevë						
Prishtinë						
Prizren						
Rahovec	8,964 €	9,200 €	236 €	3%	1	1
Ranillug	10,769 €	10,970 €	201 €	2%	1	1
Shtërpçë						
Shtime						
Skenderaj	36,880 €	36,400 €	-480 €	-1%	3	3
Suharekë						
Viti						
Vushtrri	18,338 €	18,338 €	0 €	0%	2	3
Zubin Potok						
Zveçan						
Gjithsej	291,137 €	319,153 €	28,016 €	10%	23	24

Aneksi 3. Ndarjet buxhetore në nivel qendror dhe lokal

Viti	Niveli qendror (në miliona Euro)		Niveli lokal (në miliona Euro)		Gjithsej (në miliona Euro)		Niveli qendror %		Niveli lokal %	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Pagat dhe shitesat	446.6	543.6	358.7	373.3	805.4	916.9	55%	59%	45%	41%
Mallrat dhe shërbimet	365.1	369.7	119.7	132.5	484.81	502.2	75%	74%	25%	26%
Shërbimet komunale	19.3	18.9	14.9	15.8	34.2	34.8	56%	55%	44%	45%
Subvencionet dhe transferet	1.0	1.1	30.5	35.3	1.06	1.2	97%	97%	3%	3%
Investimet kapitale	640	700.4	218.7	230.9	859.2	931.3	75%	75%	25%	25%
# i punonjësve	45,602	45,745	45,444	45,385	91,046	91,130	50%	50%	50%	50%

Aneksi 4. Linjat buxhetore për arsimin parashkollor

Investimet kapitale për arsimin parashkollor financohen nga burimet vetanake në Fushë Kosovë, Lipjan dhe Prishtinë (të shënuara me ngjyrë të verdhë në tabelë). Në Graçanicë dhe Vushtrri, investimet kapitale financohen përmes një kombinimi të burimeve vetanake dhe financimit nga qeveria (të shënuara me ngjyrë të gjelbër në tabelë). Deçani, Juniku dhe Shtërpca nuk kanë plane për investime kapitale në arsimin parashkollor.

Komuna	Perso neli	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shërbimet komunale	Subvencio net dhe transferet	Investimet kapitale	Gjithsej
Drenas	30	215,592 €	48,000 €	6,549 €			270,141 €
Fushë Kosovë	49	394,835 €	50,300 €	20,500 €		330,000 €	795,635 €
Lipjan	74	533,680 €	190,000 €	31,000 €		20,000 €	774,680 €
Obiliq	15	112,476 €	23,500 €	2,000 €			137,976 €
Podujevë	63	494,372 €	124,000 €	10,600 €		190,000 €	818,972 €
Prishtinë	280	1,950,000 €	1,155,000 €			350,000 €	3,455,000 €
Shtime	49	333,500 €	97,492 €	10,217 €			441,209 €
Graçanicë	44	236,973 €	34,120 €	10,000 €		25,550 €	306,643 €
Dragas	36	226,000 €					226,000 €
Prizren	65	464,607 €	380,000 €	1,909 €		400,000 €	1,246,516 €
Rahovec	34	260,000 €	89,000 €	8,500 €			357,500 €
Suharekë	45	315,674 €	40,000 €	5,000 €			360,674 €
Malishevë	112	777,732 €	220,559 €	4,500 €			1,002,791 €
Mamushë	4	24,913 €					24,913 €
Gjakovë	120	910,000 €	210,000 €	40,000 €			1,160,000 €
Istog	49	347,212 €	93,000 €	15,000 €		10,000 €	465,212 €
Klinë	20	157,018 €	29,112 €				186,130 €
Pejë	99	748,191 €	160,000 €				908,191 €
Leposaviq	82	315,964 €	137,000 €	10,000 €			462,964 €
Mitrovicë	62	440,000 €	100,000 €				540,000 €
Skenderaj	49	405,000 €	73,100 €	5,700 €			483,800 €
Vushtrri	68	481,052 €	100,000 €			80,000 €	661,052 €
Zubin Potok	24	87,500 €	10,000 €				97,500 €
Zveçan	30	35,600 €					35,600 €
Mitrovica Veriore	39	150,000 €	40,000 €	10,000 €			200,000 €
Gjilan	147	1,160,196 €	318,000 €	39,500 €			1,517,696 €
Kaçanik	21	160,005 €	50,000 €	15,000 €			225,005 €
Kamenicë	496	3,842,729 €	90,000 €				3,932,729 €

